



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.165/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,000.00 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 10.10.2017, me të cilën pretendon se Kandidati për kryetar të Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik LDK, Agim Veliu, ka shkelur rregullën zgjedhore 13/2013 neni 5.2 duke përfshirë fëmijë në fushatë zgjedhore. Më konkretisht në postimin e tij, postuar me dt.09.10.2017, rreth orës 23:00, në faqen e tij të facebook-ut, vërehet prezencë shumë e madhe e fëmijëve në fushatën që është mbajtur atë ditë në një fshatë të Podujevës. Postimi ka përmbajtje politike që ndërlidhet me fushatën zgjedhore. Fëmijët vërehet të jenë të përfshirë në fotot të cilat më pas janë shpërndarë për qëllime të promovimit të fushatës publike të mbajtur atë ditë.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur 3 fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, të datës 11.10.2017, theksoj se ankesa është plotësisht e pa bazuar për faktin se kandidati ynë ka postuar thjesht disa foto me fëmijë që në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si përfshirje e fëmijëve nën moshën 18 vjeçare në fushatë në kuptimin e nenit 5.2 të rregullës Zgjedhore 13/2017.

Andaj LDK ka theksuar kemi kërkuar nga z. Agim Veliu që ti largoj fotot dhe të njëjtat i ka larguar nga rrjeti social facebook me qëllim që të mos keqkuptohet dhe keqinterpretohet një veprim të tillë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se kandidati për Kryetar të Komunës së Podujevës, Agim Veliu, nga radhët e subjektit politik LDK, ka vendosur fotografi me fëmijë në llogarinë e tij Facebook, që ka të bëjë me fushatë zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton se: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre kanë theksuar se kanë larguar fotot nga rrjeti social facebook, mirëpo nuk kanë bashkangjitur asnjë dëshmi të vetme.

Paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr.165/2017 më datë 12.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.